




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Nr. 226/24
Data. 05.09.24



Prishtinë, 05 prill 2024
Kodi i ZRRE-së: V_1929_2024

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Mbështetur në Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084), Nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative (Nr. 03/L-202), dispozitivin nën pikën II. të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative A.nr. 1373/2017 të datës 15.09.2021, Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Çështje Administrative AA.nr. 990/2021 të datës 04.10.2021, Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës ARJ.nr. 116/2022 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. KI.103/23 të datës 11 mars 2024,

në seancën e mbajtur me datë 05 prill 2024 merr këtë:

V E N D I M

- I. OBLIGOHEN** - Shërbimet e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (KEDS), për zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të vërtetuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës, Gjykata Supreme e Kosovës dhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, që të bëjnë kthimin e shumës së faturuar, respektivisht kompensimin e dëmit konsumatorëve të cilët janë faturuar për shpenzimet e energjisë elektrike, në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës dhe atë, për periudhën kohore nga dt. 06.02.2012 e deri më dt. 20.10.2017.
- II. OBLIGOHEN** - Shërbimet e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (KEDS), që vlerën prej dyzet milion e tetëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e katërqind e tetëdhjetë euro (40,855,480.00 €), t'ua kthejnë vetëm konsumatorëve për shumën e paguar, të cilët vërtetohen se janë faturuar dhe kanë paguar, për energjinë e shpenzuar për katër komunat veriore të Republikës së Kosovës për periudhën nga data 06.02.2012 e deri më datën 20.10.2017.
- III. OBLIGOHEN** - Shërbimet e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (KEDS), që kompensimi i konsumatorëve sipas dispozitivit nën pikën II. të këtij Vendimi të bëhet duke zbritur faturat në baza mujore në vlerën përkatëse, për periudhën nga 01 qershor 2024 – 28 shkurt 2030.
- IV.** Vlera e kompensimit për secilin konsumator i cili e gëzon të drejtën e kompensimit sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative A. Nr. 1373/2017, kalkulohet në bazë të pjesëmarrjes së pagesës së energjisë elektrike të konsumatorit specifik ndaj vlerës totale të energjisë së faturuar nga konsumatorët që e gëzojnë të drejtën e kompensimit.
- V. OBLIGOHEN** - Shërbimet e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (KEDS), që t'i përgatisin listat e konsumatorëve të cilët vërtetohet se kanë paguar dhe iu ka lindur e drejta të kompensohen. Lista e konsumatorëve që do të kompensohen, duhet të dërgohet për informim në ZRRE.



VI. OBLIGOHEN - Shërbimet e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (KEDS) në bashkëpunim me Furnizuesit e energjisë elektrike të evidentojnë në faturimet e rregullta mujore vlerën e kompensimit ndaras nga shpenzimet e rregullta mujore.

Arsyetim

Zyra e Rregullatorit për Energji (në tekstin e mëtejshëm: ZRRE), me datë 11 mars 2024 nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka pranuar Aktgjykimin Nr. KI.103/23, me të cilën pas vlerësimit të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit ARJ.nr. 116/2022 të datës 09 mars 2023 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ka konstatuar se ky Aktgjykim nuk është në kundërshtim me par. 1 të nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me par. 1 të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata Supreme e Kosovës në konflikt administrativ përmes Aktgjykimit ARJ.nr. 116/2022 ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor kundër Aktgjykimit A.A.nr. 990/21 të datës 04.10.2022.

Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti për Çështje Administrative përmes Aktgjykimit A.A. nr. 990/21 të datës 04.10.2022 ka refuzuar ankesën, ndërsa Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative A.nr. 1373/17 të datës 15.09.2021 e ka vërtetuar.

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative përmes Aktgjykimit A.nr. 1373/2017 të datës 15.09.2021 nën pikën II. ka vendosur që të anulohet si i kundërligjshëm vendimi i të paditurës, Zyra e Rregullatorit për Energji në Prishtinë Nr. V_399_2012 i dt. 06.02.2012 dhe Detyrohet e paditura që të ndërmarr veprime që e obligojnë shërbimin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike në Kosovë SH.A. (KEDS) në Prishtinë, që të bëjë kthimin e shumës së faturuar, respektivisht kompensimin e dëmit konsumatorëve të cilët janë faturuar për shpenzimet e energjisë elektrike në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës, dhe atë për periudhën kohore nga dt. 06.02.2012 e deri më dt. 20.10.2017, në vlerën prej dyzet milionë e tetëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e katërqind e tetëdhjetë Euro (40,855,480.00 €).

ZRRE, pas pranimit të Aktgjykimit nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, nuk ka mjete juridike për të ankimuar, prandaj duhet të ndërmarr veprime ligjore për zbatim në pikëpamje juridike të gjykatës, si dhe nga vërejtjet e gjykatës lidhur me procedurën.

ZRRE vlerëson se përmes Vendimit V_399_2012 të datës 06 shkurt 2012, ka përcaktuar parametrat kyç rregullativ për periudhën rregullative 2012 – 2017, ku qëllimi i këtyre parametrave kyç rregullativ ka qenë aplikimi i tyre në përcaktimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes dhe Furnizuesin Publik.

ZRRE për ndërmarrjen e veprimeve, më të drejtë sqaron se për periudhën përfshirë nga data 06 shkurt deri me 03 maj 2013, si Operator i Shërbimeve të Shpërndarjes ka qenë i Licencuar Korporata Energjetike e Kosovës SH.A (KEK), Divizioni i Shpërndarjes Nr. i Regjistrimit ZRRE/Li_06/12, i cili ka kryer shërbimet e shpërndarjes së energjisë elektrike në tërë territorin e Republikës së Kosovës, përfshirë edhe furnizimin në katër komunat veriore të vendit.

ZRRE duke u bazuar në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për caktimin e operatorit të vetëm të rrjetit të shpërndarjes, me 01 mars 2013 ka transferuar Licencën e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes nga Korporata Energjetike e Kosovës SH.A. Divizioni i Shpërndarjes në Kompaninë



Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KKDFE-KEDS) dhe ka hy në fuqi me datë 03 maj 2013 nga data e nënshkrimit të marrëveshjes për transferimin, me rastin e privatizimit të shërbimeve të shpërndarjes dhe të furnizimit nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Pra, Shërbimet e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (KKFDE-KEDS), duke filluar nga data 03 maj 2013 deri me 13 prill 2017, kanë qenë të obliguara ligjërisht për t'i mbuluar humbjet që dalin nga energjia e shfrytëzuar por jo e paguar nga konsumatorët në pjesën veriore të Kosovës.

ZRRE me datë 13 prill 2017 duke u mbështetur në dispozitat ligjore të nenit 9, nenin 15, nenin 26, nenin 36 dhe nenin 47 të Ligjit për Rregullatorin për Energji, pas rishikimit të legjislacionit primar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës ka ndryshuar/modifikuar Licencën për Operim të Sistemit të Transmisionit me nr. ZRRE/Li_15/17, me të cilën është detyruar OST KOSTT për ti mbuluar humbjet që dalin nga energjia e shfrytëzuar por jo e paguar nga konsumatorët në pjesën veriore të Kosovës.

Pra, KOSTT SH.A. mbulimin e humbjeve që dalin nga energjia e shfrytëzuar por jo të paguar nga konsumatorët në pjesën veriore të Kosovës, e ka realizuar nga data 13 prill 2017 deri më 20.10.2017, kur Gjykata e Apelit e Kosovës, Departamenti për Çështje Administrative përmes Aktvendimit AA.nr. 451/2017 të datës 20.10.2017, ka vërtetuar Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr. 1373/2017 të datës 11.09.2017 me të cilën është shtyrë vendimi i ZRRE-së, V_399_2012 i datës 06.02.2012, deri në marrjen e Aktgjykimit lidhur me kërkesëpadinë e paditësit. ZRRE përmes njoftimit të datës 30.11.2017 ka urdhëruar KOSTT, KEDS dhe KESCO që të zbatojnë tarifën sipas këtij njoftimi, deri në vendimmarrjen e ardhshme të Bordit, pasi ky organ në atë kohë nuk ishte funksional në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm të vendimmarrjes.

ZRRE vlerëson përkundër se obligimi i shërbimit i furnizimit me energji elektrike në katër komuna në veri të Kosovës i kanë takuar ndërmarrjeve të ndryshme në periudha të caktuara kohore, si KEK nga periudha 06.02.2012 deri më 03.05.2013, KEDS nga periudha 03.05.2013 deri më 13 prill 2017, dhe KOSTT nga periudha 13 prill 2017 deri më 20.10.2017, nuk ka mundësi që të veprojnë ndryshe në zbatimin e Aktgjykimit, nga ato që kanë vendosur gjykatat përmes Aktgjykimeve përkatëse.

ZRRE, vlerëson se vendimi për të obliguar Shërbimet e Shpërndarjes Energjisë Elektrike (KEDS), për të kompensuar konsumatorët të cilët janë faturuar për shpenzimet e energjisë elektrike, në katër komuna veriore të Republikës së Kosovës dhe atë, për periudhën kohore nga dt. 06.02.2012 e deri më dt. 20.10.2017, është detyrim i përcaktuar nga Aktgjykimi i Gjykatës Themelore, dhe i vërtetuar edhe nga gjykatat tjera.

ZRRE, vlerëson se vendimi për të obliguar shërbimet e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (KEDS), që vlerën prej 40,855,480.00 €, t'ua kthejnë vetëm konsumatorëve për shumën e paguar të cilët vërtetohen se janë faturuar dhe kanë paguar për energjinë e shpenzuar për katër komuna veriore të Republikës së Kosovës për periudhën nga dt. 06.02.2012 e deri më dt. 20.10.2017, e ka mbështetur në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme bazuar në Nenin 194 të LMD, ku theksohet që: "konsumatorët të cilët pa bazë ligjore dhe pa dijeninë e tyre janë faturuar dhe kanë paguar për energjinë e shpenzuar në veri, u lindë e drejta për kthimin e shumës së paguar si kanë vendosur gjykatat e instancave më të ulëta", kjo njëherit është arsyetuar edhe në Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.



ZRRE, vlerëson se vendimi për të obliguar Shërbimet e Shpërndarjes Energjisë Elektrike (KEDS), që kompensimi i konsumatorëve të bëhet duke zbritur faturat në baza mujore në vlerën përkatëse për periudhën nga data nga 01 qershor 2024 – 28 shkurt 2030, është bazuar në arsyetimin e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese duke reflektuar frymën e zbatimit më të drejt për të gjithë palët dhe sipas Aktgjykimit. Pra, periudha e kompensimit e vendosur prej datës nga 01 qershor 2024 – 28 shkurt 2030 është për shkak se edhe konsumatorët të cilët janë ngarkuar për koston e furnizimit për katër komunitat në veri të Kosovës për disa vite, respektivisht për periudhën prej datës 06.02.2012 deri më 20.10.2017.

ZRRE, vlerëson se vendimi për të obliguar Shërbimet e Shpërndarjes Energjisë Elektrike (KEDS), për vlerën e kompensimit për secilin konsumator, i cili e gëzon të drejtën e kompensimit sipas Aktgjykimit, duhet të kalkulohet në bazë të pjesëmarrjes së pagesës së energjisë elektrike të konsumatorit specifik ndaj vlerës totale të energjisë së faturuar nga konsumatorët që e gëzojnë të drejtën e kompensimit. Kjo pasi që të drejtën e kompensimit duhet ta kenë vetëm konsumatorët të cilët kanë bërë pagesa të energjisë elektrike deri me datën e plotfuqishmërisë së Aktgjykimit.

ZRRE, vlerëson se vendimi për të obliguar Shërbimet e Shpërndarjes Energjisë Elektrike (KEDS), që t'i përgatisë listat e konsumatorëve të cilët vërtetohet se kanë paguar dhe i është lindur e drejta të kompensohen duhet të bëhen me qëllim që të evidentohen saktë numri i konsumatorëve përfitues dhe vlera e kompensimit financiar. Lista e konsumatorëve që do të kompensohen duhet të dërgohet për informim në ZRRE me qëllim të monitorimit të zbatimit të këtij Vendimi.

ZRRE, vlerëson se vendimi për të obliguar Shërbimet e Shpërndarjes Energjisë Elektrike (KEDS) që të bashkëpunoj me Furnizuesit e Energjisë Elektrike është që kompensimi sipas Aktgjykimit duhet të evidentohet në faturimet e rregullta mujore ndaras nga shpenzimet e rregullta mujore për konsumatorët e rregulluar dhe të parregulluar.

ZRRE vlerëson se të drejtën e kompensimit do ta gëzojnë vetëm konsumatorët të cilët gjatë periudhës së cekur në Aktgjykimin e Gjykatës kanë qenë aktiv dhe kanë kryer detyrimet e pagesave konform dispozitivit nën pikën II të këtij Vendimi.

Andaj, ZRRE vlerëson se zbatimi i Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative A.nr. 1373/2017 të datës 15.09.2021, Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Çështje Administrative AA.nr. 990/2021 të datës 04.10.2021, Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës ARJ.nr. 116/2022 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. KI.103/23 të datës 11 mars 2024, kanë karakter të detyrueshëm të zbatimit dhe në kuptim të nenit 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

VII. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

VIII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.




Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Lutfije Dervishi, Anëtare


Gani Buçaj, Anëtar


Arta Isufi, Anëtare


Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KEDS SH.A.
- KOSTT
- KESCO
- KEK
- Avokatit të Popullit,
- Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe
- Arkivit të ZRRE-së